



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Nr. 14-111/01-164108/2022;

Data: 14.07.2022

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenit 5, pikës c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 8/2019), nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prishtinës shpallë:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë / Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për Histori	Vend i lirë	1
2	ShFMU	Mësimdhënës/e për Histori	Zëvendësim	3
3	ShFMU	Mësimdhënës/e për Edukatë Qytetare	Vend i lirë	2
4	ShFMU	Mësimdhënës/e për Edukatë Qytetare	Zëvendësim	1
5	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjeografi	Vend i lirë	1
6	ShFMU ShML	Mësimdhënës/e për Gjeografi	Vend i lirë	1
7	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjeografi	Zëvendësim	1
8	ShFMU	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	2
9	ShFMU	Mësimdhënës/e për Matematikë	Zëvendësim	3
10	ShFMU	Mësimdhënës/e për Biologji	Vend i lirë	1
11	ShFMU	Mësimdhënës/e për Biologji	Zëvendësim	1
12	ShML	Mësimdhënës/e për Biologji	Zëvendësim	1
13	ShFMU	Mësimdhënës/e për Kimi	Vend i lirë	1
14	ShFMU	Mësimdhënës/e për Kimi	Zëvendësim	2
15	ShML	Mësimdhënës/e për Kimi	Zëvendësim	1
16	ShFMU	Mësimdhënës/e për Fizikë	Vend i lirë	1
17	ShFMU	Mësimdhënës/e për Fizikë	Zëvendësim	4
18	ShML	Mësimdhënës/e për Fizikë	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Prishtinë);
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaportë);
- Rezyrmeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit të noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Histori në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Edukatë Qytetare në shkollë të mesme të ulët:**
 - Programi/ dega: Histori Edukatë qytetare/ gjeografi-edukatë qytetare:
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
 - Programi/ dega e Historisë:
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
 - Programi/ dega e Gjeografisë:
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
 - Programi/ dega e Sociologjisë:
 - Niveli master arsimor (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjeografi në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Biologji në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Kimi në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Fizikë në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Vërejtje: Udhëzimi Administrativ nr. 05-2021 për normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të përgjithshëm përcakton se “Të gjitha nivelet e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, duhet të jenë të profilit arsimor, duke përfshirë edhe programet arsimore të njësive akademike sipas nenit 6 dhe 7 të UA-së. Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, sistemi katërvjeçar (profesor), baçelor katërvjeçar 240 ECTS kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ”.

III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2022/2023 (Shtator 2022 – Gusht 2023);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t’i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kritere: Njohuritë e përgjithshme 25 pikë; Aftësitë e përgjithshme dhe personalitetit 35 pikë; Njohuritë profesionale 40 pikë;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e Komunës të Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (bazuar në aplikacionin e kandidatit);
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Prishtinës;
- Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve;
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë nuk do të jetë domosdoshmërisht më datën 01.09.2022, por në varësi të lirimit real të vendit të punës (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë, etj).

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- **Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.07.2022 deri më datën 28.07.2022;**
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.